



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 639/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Antoneta Hulaj kandidate për kuvendin komunal në Deçan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Deçan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Antoneta Hulaj kandidate për kuvendin komunal në Deçan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Deçan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 13:00, ka pranuar një ankesë nga Antoneta Hulaj kandidate për kuvendin komunal në Deçan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Deçan, në të cilën dyshon se i mungojnë votat dhe duke kërkuar verifikimin e tyre në vendvotimet 0101X; 0101c; 0102c; 0114; 0108c

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk e ka dëshmuar me asnjë provë krahasueshmërinë e votave për të cilat pretendon se i mungojnë.

Parashtrimet në ankesë nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimet e sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesin .

Paneli vlerëso se pretendimet në ankesë nuk janë te bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmime konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë është e pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL Anr.639/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.